

Paraqitja e Zërave të të Ardhurave të Tjera Gjithpërfshirëse

(Ndryshime në SNK 1)

Ndryshime në SNK 1

Paraqitja e Pasqyrave Financiare

Paragrafi 7 është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar).

7 Termat në vijim në këtë Standard janë përdorur me këto kuptime:

...

Shënimet shpjeguese përmbajnë informacion shtesë krahasuar me atë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e rezultatit dhe pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, ...

Paragrafi 10 është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar), është shtuar paragrafi 10A dhe është fshirë paragrafi 12.

10 Një paketë e plotë e pasqyrave financiare përmban:

...një pasqyrë të rezultatit dhe një pasqyrë të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për periudhën;

...

Një njësi ekonomike mund të përdorë emërtime pasqyrash të ndryshme nga ato të përdorura në këtë Standard. Për shembull një njësi ekonomike mund të përdorë emërtimin 'pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse' në vend të emërtimit 'pasqyra e rezultatit dhe e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse'.

10A Një njësi ekonomike mund të paraqesë një pasqyrë të vetme të rezultatit dhe të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, në të cilën rezultati dhe të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse paraqiten në dy seksionin e rezultatit dhe më pas vijohet me seksionin e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse. Një njësi ekonomike mund të paraqesë seksionin e rezultatit në një pasqyrë të veçantë rezultati. Nëse veprohet kështu, pasqyra e rezultatit duhet t'i paraprijë pasqyrës që paraqet të ardhurat gjithpërfshirëse, e cila duhet të fillojë me rezultatin e periudhës.

Titujt mbi paragrafët 81 dhe 82 dhe paragrafi 82 janë ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është shënuar me vijë në mes) dhe është fshirë paragrafi 81. Janë shtuar paragrafët 81A dhe 81B, një titull dhe paragrafi 82A dhe janë fshirë paragrafët 83 dhe 84.

Pasqyra e rezultatit dhe pasqyra e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse

81A Pasqyra e rezultatit dhe pasqyra e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (pasqyra e të ardhurave gjithpërfshirëse) duhet të paraqesë përveç seksioneve të rezultatit dhe të ardhurave të tjera totale:

- (a) rezultatit (fitimin ose humbjen);
- (b) totalin e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse;
- (c) të ardhurat gjithpërfshirëse të periudhës, si shumë e rezultatit me të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse.

Nëse një njësi ekonomike paraqet një pasqyrë të veçantë të rezultatit, ajo nuk ka nevojë të paraqesë seksionin e rezultatit në pasqyrën që paraqet të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse.

81B Një njësi ekonomike do të paraqesë zërat e mëposhtëm, përveç seksioneve të rezultatit dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, si caktim (akordim) i fitimit ose humbjes dhe i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për periudhën:

- (a) fitimin ose humbjen e periudhës që i takon:
 - (i) interesave të pakicës dhe
 - (ii) zotëruesve të kapitalit neto të shoqërisë mëmë.
- (b) të ardhurat gjithpërfshirëse të periudhës që i takojnë:
 - (i) interesave të pakicës dhe
 - (ii) zotëruesve të kapitalit neto të shoqërisë mëmë.

Nëse një njësi ekonomike paraqet një pasqyrë të veçantë të rezultatit, ajo duhet të paraqesë zërat e pikës (a) në atë pasqyrë.

Informacion për t'u paraqitur në pasqyrën e të ardhurave të ardhurave totale seksionin e rezultatit ose në pasqyrën e rezultatit

82 **Minimalisht Përveç zërave të kërkuar nga SNRF-të e tjera, seksioni i rezultatit ose pasqyra e të ardhurave totale rezultatit do të përfshijë zërat që paraqesin shumat në vijim për periudhën:**

- (a) të ardhurat;
- (b) kostot e financimit;

- (c) pjesën e fitimit ose të humbjes në pjesëmarjet dhe shoqëritë e përbashkëta të kontabilizuara sipas metodës së kapitalit neto;
- (d) shpenzimet për tatimet;
- (e) [fshirë] një shumë të vetme që përfshin totalin e:
 - (i) ~~fitimit ose humbjes pas tatimit të veprimtarive të ndërprera dhe~~
 - (ii) ~~fitimit ose humbjes pas tatimit të njohura gjatë matjes me vlerën e drejtë minus koston e shitjes ose koston e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve ose grup aktiveve që përbëjnë veprimtari të ndërprerë;~~
- (ea) një shumë të vetme për totalin e veprimtarive të ndërprera (jo te vijueshme) (shih SNRF 5).
- (f)–(i) [fshirë]
- (f) ~~fitimin ose humbjen;~~
- (g) ~~çdo zë tjetër të të ardhurave të tjera totale të klasifikuar sipas natyrës (me përjashtim të shumave të cilësuar në pikën (h));~~
- (h) ~~pjesën e të ardhurave të tjera totale në pjesëmarjet dhe shoqëritë e përbashkëta të kontabilizuara sipas metodës së kapitalit neto; dhe~~
- (i) ~~të ardhurat totale.~~

Informacion për t'u paraqitur në seksionin e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse

- 82A Seksioni i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse do të përmbajë zërat që paraqesin shumat e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për periudhën, të klasifikuara sipas natyrës (përfshirë pjesën e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse në pjesëmarjet dhe shoqëritë e përbashkëta të kontabilizuara sipas metodës së kapitalit neto) dhe të grupuara në atë mënyrë që në përputhje me SNRF-të e tjera:
- (a) nuk do të riklasifikohen më pas në rezultat; dhe
 - (b) do të riklasifikohen më pas në rezultat nëse plotësohen kushtet të caktuara.

Paragrafët 85–87, 90, 91, 94, 100 dhe 115 dhe titulli mbi paragrafin 97 janë ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar and teksti i fshirë është shënuar me vijë në mes) dhe është shtuar paragrafi 139J.

- 85 **Një njësi ekonomike duhet të paraqesë zëra shtesë, tituj dhe nëntotale në pasqyrën (at) që paraqet rezultatit dhe të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse dhe në pasqyrën e veçantë të rezultatit (nëse paraqitet një e tillë), kur një paraqitje e tillë është e rëndësishme për të kuptuar performancën financiare të njësisë ekonomike.**
- 86 Duke qenë se efektet e aktiviteteve të ndryshme të një njësie ekonomike, të transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera ndryshojnë shpesh, mundësia për fitim ose humbje dhe parashikueshmëria, si dhe dhënia e informacioneve shpjeguese lidhur me përbërësit e performancës financiare, ndihmon përdoruesit për të kuptuar performancën financiare të arritur dhe në bërjen e parashikimeve për rezultatet e ardhshme. Një njësi ekonomike përfshin zëra shtesë në pasqyrën që paraqet rezultatit dhe të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse ~~dhe në pasqyrën e veçantë të rezultatit (nëse paraqitet një e tillë)~~ dhe ndryshon përshkrimet e përdorura dhe renditjen e zërave nëse kjo është e nevojshme për të shpjeguar elementët e performancës financiare. ...
- 87 **Një njësi ekonomike nuk do të paraqesë si zëra të jashtëzakonshëm asnjë zë të të ardhurave ose shpenzimeve, as në pasqyrat që paraqesin rezultatit apo të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse ose në pasqyrën e veçantë të rezultatit (nëse paraqitet një e tillë) as në shënimet shpjeguese.**
- 90 **Një njësi ekonomike do të japë informacione shpjeguese mbi shumën e tatimit mbi të ardhurat që i takon secilit përbërës-zë të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, përfshirë rregullimet e riklasifikimit, si në pasqyrën e rezultatit apo të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, ashtu dhe në shënimet shpjeguese.**
- 91 Një njësi ekonomike mund të paraqesë zëra përbërës të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse ose:
- (a) në vlerën neto lidhur me efektin tatimor përkatës, ose
 - (b) para efektit tatimor përkatës së bashku me një shumë që tregon vlerën gjithsej të efektit tatimor të këtyre zërave përbërës.
- Nëse një njësi ekonomike zgjedh alternativën (b), ajo do të shpërndajë tatimin mes zërave që mund të riklasifikohen më pas në seksionin e rezultatit dhe atyre që nuk do të mund të riklasifikohen më pas në seksionin e rezultatit.
- 94 Një njësi ekonomike mund të paraqesë rregullime riklasifikimi në pasqyrën e rezultatit dhe në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse ose në shënimet shpjeguese. Një njësi ekonomike që përfshin rregullime riklasifikimi në shënimet shpjeguese, paraqet zërat përbërës e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse pas efektit të rregullimit riklasifikues përkatës.

Informacion për t'u paraqitur në pasqyrën e rezultatit dhe pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse ose në shënimet shpjeguese

- 100 Njësitë ekonomike nxiten të paraqesin analizat e dhëna në paragrafin 99, në pasqyrën që paraqet rezultatin dhe pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse ose në pasqyrën e veçantë të rezulttit (nëse paraqitet një e tillë).
- 115 Në disa rrethana mund të jetë e nevojshme ose e dëshirueshme të ndryshohet radha e zërave të caktuar brenda shënimeve shpjeguese. Për shembull, informacioni për ndryshimet në vlerën e drejtë të njohura në rezultat mund të kombinohet me informacionin lidhur me maturimin e instrumentave financiare, ndonëse paraqitja e parë lidhet me pasqyrën që paraqet rezultatin dhe pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse ose në pasqyrën e veçantë të rezulttit (nëse paraqitet një e tillë) dhe e dyta lidhet me pasqyrën e gjendjes financiare. Pavaresisht kësaj nje njesi ekonomike duhet të mbaje një strukturë sistematike për shënimet shpjeguese për sa kohë që është e zbatueshme.
- 139J *Paraqitja e Zërave në Pasqyrën e të Ardhurave të Tjera gjithpërfshirëse* (Ndryshimet ndaj SNK 1), publikuar më Qershor 2011, ndryshoi paragrafët 7, 10, 82, 85–87, 90, 91, 94, 100 dhe 115, shtoi paragrafët 10A, 81A, 81B dhe 82A dhe fshiu paragrafët 12, 81, 83 dhe 84. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 Korrik 2012 e në vijim. Lejohet zbatimi para kesaj date. Nëse një njësi ekonomike zbaton këto ndryshime për një periudhë që fillon përpara datës 1 Korrik 2012, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

Ndryshime në SNRF-të e tjera

Kjo shtojcë paraqet ndryshimet në SNRF-të e tjera, si pasojë e publikimit nga Bordi të ndryshimeve në SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*. Paragrafët e ndryshuar paraqiten me tekst të ri të nënvizuar and teksti i fshirë është shënuar me vijë në mes. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime nëse ajo zbaton ndryshimet e SNK 1 në *Paraqitja e Zërave në Pasqyrën e të Ardhurave të Tjera gjithpërfshirëse*.

SNRF 1 *Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Herë të Parë*

Paragrafi 21 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 39K.

- 21 Për të qënë në pajtim me SNK 1, pasqyrat e para financiare sipas SNRF-ve duhet të përfshijnë të paktën tre pasqyra të pozicionit financiar, dy pasqyra të rezulttit dhe të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, dy pasqyra të veçanta të të ardhurave të rezulttit (nëse paraqitet një pasqyrë e tillë), dy pasqyra të lëvizjeve në mjetet monetare dhe dy pasqyra të ndryshimeve në kapital dhe shënimet shpjeguese përkatëse, përfshirë informacionin krahasues.
- 39K *Paraqitja e Zërave në Pasqyrën e të Ardhurave të Tjera gjithpërfshirëse* (Ndryshimet ndaj SNK 1), publikuar më Qershor 2011, ndryshoi paragrafin 21. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë ndryshim nëse zbaton SNK 1 e ndryshuar në Qershor 2011.

SNRF 5 *Aktivet Afatgjata që Mbahen për t'u Shitur dhe Operacionet Jo të Vijueshme*

Paragrafi 33A është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 44I.

- 33A Nëse një njësi ekonomike paraqet përbërësit zërat e rezulttit në një pasqyrë të veçantë të të ardhurave siç përshkruhet në paragrafin 81 10A të SNK 1 (i rishikuar ndryshuar në 201107), në këtë pasqyrë të veçantë duhet të paraqitet një seksion i identifikuar si i lidhur me operacionet jo të vijueshme.
- 44I *Paraqitja e Zërave në Pasqyrën e të Ardhurave të Tjera gjithpërfshirëse* (Ndryshimet ndaj SNK 1), publikuar më Qershor 2011, ndryshoi paragrafin 33A. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë ndryshim nëse zbaton SNK 1 e ndryshuar në Qershor 2011.

SNRF 7 Instrumentat Financiarë: Dhënie Informacionesh Shpjeguese

Paragrafi 27B është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 44Q.

27B Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për secilën klasë të instrumentave financiarë për matjet me vlerën e drejtë të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar:

...

(c) për matjet me vlerën e drejtë në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë, një rakordim të tepricave fillestare me tepricat në fund, duke paraqitur veçmas ndryshimet gjatë periudhës që u takojnë sa vijon:

(i) totalit të fitimeve ose humbjeve të periudhës të njohura në rezultat dhe një përshkrim se ku paraqiten ato në pasqyrën e rezulttit dhe pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse ose në pasqyrën e veçantë të të ardhurave (nëse paraqitet një e tillë);

...

(d) shumën e totalit të fitimeve ose humbjeve të periudhës në pikën (c)(i) më sipër të përfshirë në rezultat që i takon fitimeve ose humbjeve të lidhura me aktivet dhe passivet e mbajtura deri në fund të periudhës së raportimit dhe një përshkrim se ku janë paraqitur këto fitime apo humbje në pasqyrën e rezulttit dhe pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse ose në pasqyrën e veçantë të të ardhurave (nëse paraqitet një e tillë).

...

44Q *Paraqitja e Zërave në Pasqyrën e të Ardhurave të Tjera gjithpërfshirëse* (Ndryshimet ndaj SNK 1), publikuar më Qershor 2011, ndryshoi paragrafin 27B. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë ndryshim kur ajo zbaton SNK 1 të ndryshuar në Qershor 2011.

SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat

Paragrafi 77 është ndryshuar, është fshirë paragrafi 77A dhe është shtuar paragrafi 98B.

77 **Shpenzimi (e ardhura) tatimor(e) që lidhet me fitimin ose humbjen nga veprimtaritë e zakonshme duhet të paraqitet si pjesë e rezulttit në pasqyrën e rezulttit dhe pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.**

98B *Paraqitja e Zërave në Pasqyrën e të Ardhurave të Tjera gjithpërfshirëse* (Ndryshimet ndaj SNK 1), publikuar më Qershor 2011, ndryshoi paragrafin 77 dhe fshiu paragrafin 77A. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime kur zbaton SNK 1, të ndryshuar në Qershor 2011.

SNK 20 Kontabiliteti i Granteve Qeveritare dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Ndhimën Qeveritare

Paragrafi 29 është ndryshuar, është fshirë paragrafi 29A dhe është shtuar paragrafi 46.

- 29 Grantet që lidhen me të ardhurat, ~~ndonjëherë~~ paraqiten si ~~një e ardhur në pasqyrën e të ardhurave të tjera totale pjesë e rezultati~~ ose veçmas ose nën një grupim të përgjithshëm të tillë si “ Të ardhura të tjera”; ose ndryshe, ato zbriten në raportimin e shpenzimeve me të cilat lidhen.
- 46 *Paraqitja e Zërave në Pasqyrën e të Ardhurave të Tjera* gjithpërfshirëse (Ndryshimet ndaj SNK 1), publikuar më Qershor 2011, ndryshoi paragrafin 29 dhe fshiu paragrafin 29A. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime nëse zbaton SNK 1 të ndryshuar në Qershor 2011.

SNK 21 Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit

Paragrafi 39 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 60H.

- 39 **Rezultatet dhe pozicioni financiar i një njësie ekonomike, monedha funksionale e të cilës nuk është monedhë e një ekonomie hiperinflacioniste, do të përkthehen në një monedhë paraqitjeje të ndryshme duke ndjekur procedurat e mëposhtme:**
- ...
- (b) **të ardhurat dhe shpenzimet e çdo pasqyre që paraqet rezultatin dhe të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse ose pasqyre të veçantë të të ardhurave (d.m.th. duke përfshirë shumat krahasuese) do të përkthehen me kursin e këmbimit të datës të kryerjes së transaksionit; dhe**
- (c) ...
- 60H *Paraqitja e Zërave në Pasqyrën e të Ardhurave të Tjera* gjithpërfshirëse (Ndryshimet ndaj SNK 1), publikuar më Qershor 2011, ndryshoi paragrafin 39. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim kur ajo zbaton SNK 1 e ndryshuar në Qershor 2011.

SNK 32 Instrumentet Financiarë: Paraqitja

Paragrafi 40 është ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 97K.

- 40 Dividendët e klasifikuar si shpenzime mund të paraqiten në pasqyrën e rezultatit dhe pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse ose në pasqyrën e veçantë të të ardhurave (nëse paraqitet një e tillë) ose se bashku me shpenzimet e

interesit në detyrimet e tjera, apo edhe si zë i veçantë. Përveç kërkesave të këtij Standardi, dhënia e informacioneve për interesin dhe dividendët është subjekt i kërkesave të SNK 1 dhe SNRF 7. Në disa rrethana, për arsye se ka diferenca me interesit dhe dividendëve, në lidhje me çështje të tilla si zbritshmëria tatimore, është e dëshirueshme të jepen informacione të veçanta për to në pasqyrën e rezultetit dhe pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse ose në pasqyrën e veçantë të të ardhurave (nëse paraqitet një e tillë). Dhënia e informacioneve shpjeguese për efektet tatimore bëhet në përputhje me SNK 12.

- 97K *Paraqitja e Zërave në Pasqyrën e të Ardhurave të Tjera gjithpërfshirëse* (Ndryshimet ndaj SNK 1), publikuar më Qershor 2011, ndryshoi paragrafin 40. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë ndryshim kur ajo zbaton SNK 1 e ndryshuar në Qershor 2011.

SNK 33 Fitimet për Aksion

Paragrafët 4A, 67A, 68A dhe 73A janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 74D.

- 4A** Nëse një njësi ekonomike paraqet ~~përbërësit zërat~~ zërat e rezultetit në një pasqyrë të veçantë të ardhurash siç përcaktohet në paragrafin ~~84~~ 10A të SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* (i ~~rishikuar ndryshuar në 201107~~), ajo do të paraqesë fitimet për aksion vetëm në atë pasqyrë të veçantë.
- 67A Nëse një njësi ekonomike paraqet ~~përbërësit zërat~~ e rezultetit në një pasqyrë të veçantë të ardhurash siç përcaktohet në paragrafin ~~84~~ 10A të SNK 1 (i ~~rishikuar ndryshuar në 201107~~), ajo do të paraqesë në atë pasqyrë të veçantë fitimet bazë dhe të pakësuara për aksion, në përputhje me paragrafët 66 dhe 67.
- 68A Nëse një njësi ekonomike paraqet ~~përbërësit zërat~~ e rezultetit në një pasqyrë të veçantë të ardhurash siç përcaktohet në paragrafin ~~84~~ 10A të SNK 1 (i ~~rishikuar ndryshuar në 201107~~), ajo do të paraqesë në atë pasqyrë të veçantë ose në shënimet shpjeguese, fitimet bazë dhe të pakësuara për aksion nga operacionet jo të vijueshme, në përputhje me paragrafin 68.
- 73A** Paragrafi 73 zbatohet edhe për një njësi ekonomike që jep informacione shpjeguese, si shtesë e atyre të dhëna për fitimet bazë dhe fitimet e pakësuara për aksion, mbi shumat për aksion duke përdorur një ~~përbërës zë~~ të raportuar në ~~rezultat pasqyrën e veçantë të të ardhurave~~ (siç përshkruhet në paragrafin ~~81 të SNK 1~~ (i ~~rishikuar në 2007~~)), të ndryshëm nga ai i kërkuar nga ky Standard.
- 74D *Paraqitja e Zërave në Pasqyrën e të Ardhurave të Tjera gjithpërfshirëse* (Ndryshimet ndaj SNK 1), publikuar më Qershor 2011, ndryshoi paragrafët 4A,

67A, 68A dhe 73A. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime kur ajo zbaton SNK 1 e ndryshuar në Qershor 2011.

SNK 34 Raportimi Financiar i Ndërmjetëm

Paragrafët 8, 8A, 11A dhe 20 janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 51.

8 Një raport financiar i ndërmjetëm përmban, minimalisht, përbërësit e mëposhtëm:

...

(b) një pasqyrë të përmbledhur ose pasqyra të përmbledhura të rezulttit dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, ~~të paraqitur ose;~~

(i) ~~si një pasqyrë e vetme e përmbledhur; ose~~

(ii) ~~si një pasqyrë e veçantë e përmbledhur e të ardhurave dhe si një pasqyrë e përmbledhur e të ardhurave totale;~~

(c) ...

8A Nëse një njësi ekonomike paraqet përbërësit zërat e rezulttit në një pasqyrë të veçantë të ardhurash siç përcaktohet në paragrafin 84 10A të SNK 1 (i rishikuar ndryshuar në 201197), ajo do të paraqesë informacion të ndërmjetëm të përmbledhur nga kjo pasqyrë e veçantë.

11A Nëse një njësi ekonomike paraqet përbërësit zërat e rezulttit në një pasqyrë të veçantë të ardhurash siç përcaktohet në paragrafin 84 10A të SNK 1 (i rishikuar ndryshuar në 201197), ajo do të paraqesë në atë pasqyrë të veçantë fitimet bazë dhe të pakësuara për aksion.

20 Raportet e ndërmjetme duhet të përfshijnë pasqyrat financiare të ndërmjetme (të përmbledhura ose të plota) për periudhat si më poshtë:

...

(b) pasqyrat e rezultatit dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për periudhën e ndërmjetme aktuale dhe progresive për vitin financiar aktual deri në datën e raportimit, me pasqyrat krahasuese të rezultatit dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për periudhat e ndërmjetme të krahasueshme (aktuale dhe progresive nga fillimi i vitit deri në datën e raportimit) të vitit financiar paraardhës. Sipas SNK 1 (i

rishikuar ndryshuar në 201107), një raport i ndërmjetëm mund të paraqesë për secilën periudhë ose një pasqyrë të vetme ose pasqyra të rezultatit dhe të të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, ose një pasqyrë që tregon përbërësit e rezultatit (pasqyrë e veçantë e të ardhurave) dhe një pasqyrë të dytë që fillon me rezultatin dhe tregon përbërësit e të ardhurave të tjera totale (pasqyra e të ardhurave totale).

- 51 *Paraqitja e Zërave në Pasqyrën e të Ardhurave të Tjera* gjithpërfshirëse (Ndryshimet ndaj SNK 1), publikuar më Qershor 2011, ndryshoi paragrafët 8, 8A, 11A dhe 20. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime kur ajo zbaton SNK 1 e ndryshuar në Qershor 2011.